



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 23.05.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, N- 303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Slobodan Petroviq, Xhavit Haliti, Bislim Zogaj, Luljeta Veselaj-Gutaj, Vjosa Osmani dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Njomza Emini- (udhëtim zyrtar), Valdete Bajrami, Arben Gashi dhe Time Kadrijaj.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi zëvendëskryetari dytë i Komisionit, z. Slobodan Petroviq.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10. 05. 2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkesve dhe punëdhënësve, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

6. Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.05.2016

Kryesuesi i Komisionit i pyeti anëtarët se a kanë vërejtje në procesverbal.

Vjosa Osmani tha se edhe në mbledhjet e kaluara është kërkuar, që në rastet kur mungojnë deputetët dhe gjinden në udhëtime zyrtare, mos të shënohet vetëm mungon, por edhe të evidentohet se gjendet në udhëtim zyrtar, apo është i sëmurë. Të evidentohen arsyet e mungesës nëse bëhen të njohura nga deputeti.

Kryesuesi konstatoi se procesverbali u miratua me këtë vërejtje dhe u vendos që tani e tutje kur deputeti mungon të evidentohen arsyet e mungesës, nëse bëhen të njohura paraprakisht nga ana e deputetit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi lidhur me këtë Projektligj tha se me vendim të seancës ky projektligj duhet të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar, andaj sot është dita e fundit që ne duhet të dalim me rekomandim si Komision, në vazhdim paraqiti opinionin ligjor, pas shqyrtimit dhe verifikimit është konstatuar se projektligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe pjesërisht është në përputhje me Acquis të BE-së.

Prandaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Lidhur me këtë e hapi diskutimin.

Vjosa Osmani tha se siç e dimë ky Projektligj po shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar dhe ne, deputetët, e kemi kohën e kufizuar, por është me rëndësi të potencohet se është një nga ligjet më të rëndësishme për luftimin e krimit dhe korrupsionit në vend dhe jo vetëm nocionit të krimit që jemi mësuar ta dëgjojmë, mirëpo edhe një ndër veprat më të renda penale të përfshira në legjislacionin e Kosovës e që është terrorizmi. Kur e kemi miratuar në Kuvend ligjin i cili parandalon qytetarët e Kosovës të marrin pjesë në luftërat e huaja, pata potencuar që çështja më e rëndësishme me të cilin nuk është marrë ai ligj sa duhet, është terrorizmi dhe këtu është thelbi për të parandaluar vepra të tilla penale. Prandaj është mirë që tani me këtë ligj kemi dispozita shumë më të avancuara në të cilat mirën parasysh edhe direktivat e BE-së.

Përkundër faktit, fatkeqësisht po e përdorim procedurën e përshpejtuar, gjë e cila kritikohet prej BE-së, por është esenciale që Qeveria në të ardhmen të mos e zvarris kalimin e këtyre ligjeve për muaj të tërë dhe mos ta qet Kuvendin e Kosovës në pozitë të atillë që brenda javës të miratojë ligje të rëndësishme kaq të madhe, sepse deputetët nuk po kanë kohë të analizojnë sa duhet dhe ne nuk po mundemi as me paraqitur amendamente sepse ka kaluar afati.

Si përfundim tha se për ligjet e tilla të rëndësishme më të madhe, që kanë për qëllim ta parandalojnë korrupsionin, pastrimin e parave dhe të parandalojnë financimin e terrorizmit për një vend, siç është Kosova, është me rëndësi të kemi debat publik dhe të kemi njohuri ne mesin deputetëve

dhe të kemi kohë të mjaftueshme edhe ne, si Kuvend, e jo vetëm ata që e sponsorizojnë ligjin, në mënyrë që kur të votojmë, ta votojmë atë ligj me vetëdije të plotë se jemi duke dhënë kontribut të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e fenomeneve të tilla. Unë i jap përkrahje këtij ligji, por vërejtjet ishin sa i përket procedurave.

Kryesuesi tha se pajtohet me diskutimin e parafolëses që shqyrtimi me procedurë të përshpejtuar nuk po u lënë deputetëve më shumë kohë në analizimin e projektligjeve.

Pas votimit të projektligjit kryesuesi konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinionin ligjor. Ky Projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të procedohet për miratim.

Lidhur me këtë Projektligj e hapi debatin.

Pas votimit kryesuesi konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të procedohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit është konstatuar se projektligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE- *Çështjet e rregulluara dhe të adresuara në këtë Projektligj, nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Pra, shtetet anëtare të BE-së këtë fushë e rregullojnë sipas politikave dhe legjislacionit të tyre të brendshëm.*

Pas votimit Kryesuesi konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të procedohet për miratim në Kuvend

6. Të ndryshme

Xhavit Haliti –Ne, si Komisioni, i kemi bërë ftesë ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Drejtësisë të marinë pjesë në mbledhje të Komisionit, por nuk kemi marrë përgjigje deri më tani. Kjo është shkelje e rëndë e Rregullores së punës dhe obligimeve kushtetuese. Andaj kërkoj të ju përsëritet ftesa ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministri të Drejtësisë për të sqaruar çështjet që kanë të bëjnë me situatën e krijuar në Kumanovë.

Vjosa Osmani pajtohet që t’u përsëritet ftesa ministrave, por tha se temat që ftohen ministrat të jenë brenda suazave të Komisionit tonë. Në vitet e fundit nuk ka pasur problem ky Komision, gjithmonë kemi pasur përgjigje pozitive nga ministrat, në çdo kohë kur janë ftuar. Por nëse përsëri nuk marrim përgjigje nga ministrat këtë çështje duhet ta ngrehim në Kuvend, dhe kjo tani nuk është normale, është injorim i interesave të qytetarëve, sepse interesat e qytetarëve dëgjohen dhe përfaqësohen këtu. Nëse ka nevojë të propozojmë edhe rezolutë që flet për pa përgjegjësinë e ministrave të caktuar në raport me Kuvendin e Kosovës.

Xhavit Haliti – Meqenëse kemi të bëjmë me çështje të ndjeshme edhe për opinionin dhe interesat e Kosovës, veçanërisht tani kur po pritet liberalizimi i vizave, kemi akoma paqartësi për çështjen e demarkacionit, duke marrë parasysh përgjegjësit, është mirë në Komision të ftojme Komisionin e ngarkuar nga Qeveria për të diskutuar me Komisionin e Malit të Zi, të cilët kanë përgatitur materialin për miratim në Qeveri dhe miratim në Parlament.

Duhet të fillohet nga Komisioni ynë dhe të kalohet te komisionet e tjera të interesuara të Parlamentit, sepse kemi ra në një pozitë të pa lakmueshme sa i përket raporteve me opinionin dhe si vend, në një anë kemi shkopin, e në anën tjetër karotën, përballemi me qytetar të cilët janë kundër jo demarkacionit, shumë herë kur po diskutohet po krijohet përshtypja se jemi kundër demarkacionit. Ne nuk jemi dhe nuk duhet askush nga qytetarët të jetë, por t’i informojmë me situatën që po përballemi e që janë të lidhura me pretendimet që nuk janë të pakta nga disa specialistë dhe deputetë që merren me fushën e caktuar që kjo çështje të vijë në vendin e vet.

Nuk është mirë që qytetarët tanë t’i lejojmë në situatë amullie dhe t’ju lejojmë hapësirë pastaj grupeve ekstremiste të cilit do krahar, që të manipulojnë! Pastaj nesër me idenë, qoftë të tradhtisë së dikujt, në raport me interesat e Kosovës, qoftë të gabimeve ose kusurritjeve të interesave grupore dhe personale të territoreve që kanë të bëjnë me Kosovën.

Besoja që ftuarja e Komisionit dhe sqarimi i z. Mehes në Komision dhe në komisione të Parlamentit do të ishte i mirë, sepse jemi në situatë që ose të vendosim për këtë çështje sipas të dhënave historike, ose të shikojmë për bisedime shtesë me Malin e Zi.

Një pjesë e madhe e koalicionit qeverisës është për ta nënshkruar kështu si është, kurse një pjesë është të vazhdohen debatet, kurse një pjesë është kundër. Ne duhet të jemi të përgjegjshëm sepse demarkacionin duhet ta bëjmë edhe me Serbinë dhe me shtetet fqinje, por interesat tona duhet të mbrohen dhe kufijtë të mos vendosen ku pengojnë jetën e qytetarëve dhe të ruhen pronat e tyre. Është me interes që obligimet tona në drejtim të zbatimit të MSA-së dhe liberalizimit të vizave të informohemi nga dora e parë, t’i shohim argumentet nga ata të cilët kanë shënjuar kufirin, pa tensione nëse duhet edhe pa media. Pra, ideja ime është që para se marrëveshja të vijë në Kuvend për ratifikim, të jemi të njoftuar për mënyrën si ka punuar Komisioni dhe problemet që janë me këtë çështje, e pastaj të vendosim si do të votojmë si deputetë.

Bislim Zogaj pajtohet me diskutimin e parafolësit, por tha të shikohet mundësia që në atë takim të ftohet edhe pala tjetër e cila e kundërshton marrëveshjen dhe disa ekspert. Pastaj të

ballafaqohen me argumente në prezencën tanë dhe do të ishte mirë që të mbahet takimi me Komisionin para se të kalojë në seancë plenare.

Vjosa Osmani- Përveç Komisionit tanë dhe komisionit shtetëror propozoi të ftohen edhe një listë njerëzish në takim, deputetët që kanë qenë më aktivë, që kanë qenë pro dhe kundër kësaj çështje, si dhe 5 -6 emra nga komuniteti i ekspertëve që kanë qenë ma aktivë në përgatitjen, qoftë publikimeve dhe prezantimeve të opinioneve rreth kësaj çështje, siç janë prof Zejnullah Gruda, Muhamet Carabregu, dhe disa të tjerë, të kemi ballafaqim të drejtpërdrejtë dhe jo vetëm nëpërmjet mediave. Në një takim zyrtar të këtij Komisioni duhet të na përgjigjet komisioni shtetëror, sepse ne me vite të tëra jemi marrë me secilin kriter të liberalizimit të vizave dhe si deputetë të kemi informata pse ka ardhur deri te kjo, dhe cili do të jetë vendimi përfundimtar i deputetëve individualisht.

Kryesuesi në fund, pas diskutimeve, kërkoi nga administrata që t'i bëjë ftesë Komisionit shtetëror për demarkacionin z. Murat Meha dhe ftesë ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Drejtësisë që të marrin pjesë në mbledhjet e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetar i dytë i Komisionit,

Sllobodan Petroviq